

Drejtoria Rajonale Tirane

## PROCESVERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR – PUNË”**

#### OBJEKTI I PROCEDURËS:

*“Zgjatimi i rrjetit TU te kabinave elektrike ne N/St TEC, Kombinat dhe N/St Kombinat i Ri 110/20 kV”*

#### KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**45231400-9 - Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike**

#### VLERA E FONDIT LIMIT:

**4,671,545 (kater million e gjashtëqind e shtatedhjete e nje mije e peseqind e dyzet e pese) Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## Drejtoria Rajonale Tirane

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet:

*”Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. **Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*”.

Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotësojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë projektin..

## Drejtoria Rajonale Tirane

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29% dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më të vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përmirësimi i infrastrukturës së linjave TU kërkon një kohë të konsiderueshme për të kryer punët me sukses dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.

Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur.

Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

## Drejtoria Rajonale Tirane

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale, në fushën e zbatimit të punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategorite e mëposhtme:*

*Punime të përgjithshme/specialë ndertimi:*

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi në tokë</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesme dhe shpërndarjen e energjisë</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-8</i>	<i>Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri</i>	<i>Klasifikimi A</i>

***Shenim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategorite e përkruara, duhet ta ketë të njëjshuar pranë organeve perkatese në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.***

*Ne rast bashkimi të operatoreve ekonomike, secili anëtar duhet të paraqesë licensat në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.*

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku citohet:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

## **Drejtoria Rajonale Tirane**

Konkretisht :

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

a) Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A** “Punime gërmimi në tokë”: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv në seksionin “Punime ndërtimore”, konkretisht këtu përfshihet zëri me emërtesë (3-46/1, 3-498/b)

Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A.

b) Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P – 11 A “N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore..

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv, në rubrikat me emërtesë “PUNIME ELEKTRIKE”. Licencat për punimet e përgjithshme të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për çdo kategori licence.

### Drejtoria Rajonale Tirane

Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0-20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”.

- c) Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 8 A** “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri”: Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal .

Konkretisht këtu përfshihen punimet prej betoni te armuar. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “ A.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihet zëri me emërtesë (2-262/4, 2-261, 2-286, 3-209, 3-182/a, 3-182/c, 2.258)

*2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si drejtues teknik, te perfshire ne licencen e zbatimit te shoqerise, te pakten:*

- *1 (nje) inxhinier elektrik*

*Punonjesit e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontraten individuale te punes, shoqeruar me diplomen dhe CV-ne perkatese te inxhinierëve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaraje me shkrim se inxhinieret e pershkruar mesiper duhet te jene te pa angazhuar ne kontrata te tjera dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates.*

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## Drejtoria Rajonale Tirane

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**ARGUMENTIM:** Kriteri i punësimit të një inxhinieri elektrik është i rëndësishëm për disa arsye. Me qëllim ndërtimin e objektit të vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e një inxhinieri elektrik si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve . Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit. Kërkesa për të siguruar që inxhinieri elektrik është i regjistruar dhe i siguruar në listat e pagesave të sigurimeve për një periudhë të caktuar siguron se operatori ekonomik respekton të gjitha detyrimet legjislativë dhe siguron që punonjësit janë të mbrojtur në rast të ndonjë aksidenti ose dëmtimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontratën individuale të punës, diplomën e inxhinierit, CV dhe liste pagesa.

**2.3.4** *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 13 (trembedhjete) punonjës me kohë të plotë pune ku përfshihet dhe stafi inxhinieroteknik për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet të jene të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me këte pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë listepagesat perkatese E-Sig.*

**Sqarim:** *përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe*

## Drejtoria Rajonale Tirane

nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

**ARGUMENTIM:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;



## Drejtoria Rajonale Tirane

*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat, specifikat e kontratës dhe llojin e procedurës- e hapur e thjeshtuar. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit si dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit duke përfshirë ketu numrin total të punonjësve (inxhinierë, teknike, specialiste, punonjës të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj).

**2.3.5** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 5 (pese) elektrikistë, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik minimumi me grupi II të vlefshme, nga të cilët:*

- *minimumi 2 (dy) të jenë elektrikistë me grupin e sigurimit teknik III të vlefshme, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.*
- *minimumi 2 (dy) të jenë elektrikistë me grupin e sigurimit teknik IV të vlefshme, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.*

Lidhur me këto pike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i. Listpagesat E-Sig të punonjësve të sipercituar, si dhe
- ii. Kartelat perkatese të vlefshme të sigurimit teknik.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**ARGUMENTIM:** Ky kriter është vendosur në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM Nr 285 datë 19.05.2021”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

### **Drejtoria Rajonale Tirane**

Per kerkesen per specialiste elektriciste, njesia e prokurimit eshte bazuar ne punimet elektrike qe do behen sipas zerave perkates te preventivit.

AK ka kerkuar *8 elektriciste te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik minimumi me grupin II te vlefshme.*

Ky kriter eshte vendosur ne baze te oreve te punes sipas preventivit per kryerjen e punimeve ne linjat elektrike TU dhe gjithashtu bazuar ne Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet elektrike.

Bazuar ne kete rregullore elektricistet me grupin II te kualifikimit duhet te jene persona

- qe kane njohuri fillestare teknike per impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike
- duhet te kene njohuri te plota mbi rrezikun qe paraqet rryma elektrike dhe afrimi prane percjellesave me tension
- njohuri mbi masat kryesore te mbrojtjes gjate punimeve ne impiante, instalime dhe pajisje elektrike
- njohuri praktike mbi dhenien e ndihmes se pare

Persa i perket kerkeses qe *minimumi 2 (dy) te jene elektricistë me grupin e sigurimit teknik III te vlefshme*, bazuar ne kete rregullore keta persona duhet te jene me te specializuar ne keto drejtime:

- duhet te kene njohuri te plota mbi konstruksionin e impianteve elektrike ose te linjave qe sherbejne
- njohuri te plota mbi rrezikun qe paraqet rryma elektrike gjate punimeve ne impiantet ose linjat elektrike
- njohuri mbi rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik dhe vecanerisht rregullat e lejimit te brigadave ne punimet elektrike
- njohuri te rregullave te vecanta te sigurimit teknik per ato lloj punimesh qe futen ne kuadrin e detyrave te tij
- te dije te ushtroje kontrollin mbi punetoret qe punojne ne impiantet dhe linjat elektrike
- te zoterojne mire rregullat e dhenies se ndihmes se pare dhe te dijne te bejne praktikisht frymemarrjen artificiale

### Drejtoria Rajonale Tirane

Persa i perket kerkeses qe *minimumi 2 (dy) te jene elektrikistë me grupin e sigurimit teknik IV te vlefshme*, bazuar ne kete rregullore keta persona duhet te jene me te specializuar ne keto drejtime:

*-kane aftesi te plote ne organizimin e punimeve ne impiantet dhe linjat elektrike si dhe per mbikqyrjen e punonjesve gjate punes*

*-njohjen e plote te skemes se impiantit, te karakteristikave te pajisjeve, te vendosjes se pajisjeve te sektorit te punes se tij*

*-njohuri te plota mbi rregullat e provave dhe perdorimit te mjeteve mbrojtese*

Gjate punimeve te shtrirjes se linjave ajrore dhe kabllore TU, qe ne kete rast eshte afersisht 2.286 km, eshte I nevojshem drejtuesi I punimeve (elektricisti me grupin IV).

Ne momentin e perfundimit te investimit, pra kur jane shtrire linjat ajrore dhe kabllore TU dhe jane vendosur shtyllat beton arme, behet venia ne tension pjese pjese nga punonjesi me grupin IV.

Ne kete moment keta punonjes te kesaj kategorie kane te drejten e hapjes se dokumentit “Flete-Punimesh”, ne te cilen ky punonjes caktohet si udhezues, mbikqyres per punimet.

Keta punonjes jane te domosdoshem si drejtues punimesh kur ka linje TU ajrore dhe kabllore, kabina box per arsye se kur vihet pjese pjese ne tension hapet dokumenti “Flete-Punimesh”, I cili siglohet nga lejuesi dhe drejtuesi I punimeve.

*2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e Tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar.*

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

**Argumentimi:** Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin

### Drejtoria Rajonale Tirane

në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

#### 2.3.7 Makineri Pajisje

Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

<i>Nr.</i>	<i>Mjetet/ makineri dhe pajisje</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Autovinc 5 ton</i>	<i>1 cope</i>
2	<i>Eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup></i>	<i>1 cope</i>
3	<i>Kamion 5-7 ton veteshkarkues</i>	<i>1 cope</i>
4	<i>Vinc kulle 0.5-1 ton, teleskopik per h&gt;7m</i>	<i>1 cope</i>
5	<i>Kenotron kablli</i>	<i>1 cope</i>
6	<i>Tokmak</i>	<i>1 cope</i>
7	<i>Betoniere kantieri</i>	<i>1 cope</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier", si më poshtë vijon:

13	<i>Mjete mbrojtese</i>	<i>Minimumi</i>
	<i>a. Kokore</i>	<i>5 cope</i>
	<i>b. Fikse Zjarri</i>	<i>5 cope</i>
	<i>c. Tabela Sigurimi Teknik</i>	<i>5 cope</i>
	<i>d. Kuti Ndhimje e shpejte</i>	<i>5 cope</i>

Për mjetet që shihen në regjistra publike duhet të paraqitet dokument që verteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); të vlefshme. Për mjetet e siguruar me qera, të paraqiten dokumentet që vertetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe

### **Drejtoria Rajonale Tirane**

siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

***Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**ARGUMENTIM:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

### Drejtoria Rajonale Tirane

që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjetëve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

*2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2(dy) manovratore të pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, të leshuar nga organet kompetente, të cilët duhet të jenë të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (nese automjetet janë në pronësi të OE ofertues).*

*Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratoret e pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, mund të kontraktohen nga OE ofertues për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi.*

*Ne lidhje me manovratorin e makinerive të renda të paraqiten dëshmitë e drejtimit të leshuar nga Ministria përkatëse.*

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë

### Drejtoria Rajonale Tirane

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*2.3.9 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si me poshtë*

- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (te vlefshme)
- ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (te vlefshme)
- ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (te vlefshme)

*Ne rast bashkimi të operatoreve ekonomike, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën ISO në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.*

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë

### **Drejtoria Rajonale Tirane**

pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

### **Konkretisht:**

- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent , pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa në lidhje është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 dhe objekti i saj të



### **Drejtoria Rajonale Tirane**

perputhet me mallrat e kerkuara, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

#### *2.3.11 Per listen e meposhtme te mallrave:*

- 1. Kabell TU ABC, sipas specifikimeve teknike.*
- 2. Kabell Al TU me izolacion XLPE, sipas specifikimeve teknike*
- 3. Kabell koaksial sipas specifikimeve teknike*
- 4. Koka(terminale) kablli TU, sipas specifikimeve teknike.*
- 5. Shtylla betoni arme te centrifuguara,sipas specifikimeve teknike.*

#### *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

1. Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtuesmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

### **ARGUMENTIM:**

**1.** Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo

### **Drejtoria Rajonale Tirane**

prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plote të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

**2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.**

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e

### Drejtoria Rajonale Tirane

bleresit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

**3.** Kjo kerkese ne lidhje me testimet zyrtare eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Së pari, paraqitja e deshmive të testimeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standardet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmite e testimeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testimeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testimeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

*2.3.12 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 te ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.**

## Drejtoria Rajonale Tirane

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qender derguar me e mail ne Drejtorine Rajonale Tirane e OSSH sh.a.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

**Data 08.01.2024 Ora 13.00**

**Vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .**

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**